

# Butrinti - historiku i shkurtër i një qyteti të lashtë

Historia e Butrintit, qytetit – port antik është një fragment i historisë së botës mesdhetare. Qyteti antik përbën destinacionin kulturor turistik më të vizituar në vend.

Shumë nga monumentet që vizitohen në qytetin antik janë zbuluar nga Misioni Arkeologjik Italian, drejtuar nga Luigi Maria Ugolini, i cili punoi për gati 10 vjet në Butrint (1928-1939).

Ajo çka Butrinti ofron sot është një rrugëtim mbresëlënës përgjatë epokave të historisë, fillesa e të cilit daton në shek. e 8-të p. Kr. Qyteti i dikurshëm dhe trashëgimia e tij ruan dëshmi unike të kulturave dhe qytetërimeve helenistike, romake, bizantine, veneciane dhe osmane.

Sipas mitologjisë klasike, qyteti i lashtë i njohur si *Buthrotum* u themelua nga mërgimtarët që braktisën Trojën pas rënies së qytetit. Në poemën epike Eneida, poeti latin Virgjili rrëfen për Eneun, që vizitoi Butrintin gjatë rrugës së tij për në Itali.

Të dhënat e gërmimeve arkeologjike disavejçare dëshmojnë se aty rreth shek. 4-të p. Kr. vendbanimi i lashtë u rrethua me mure mbrojtëse dhe qyteti gradualisht u kthye në një qendër kulturi. Një fältore kushtuar Asklepit, perëndisë së mjekësisë, u ndërtua në shpatin jugor të kodrës së akropolit. Një mbishkrim i shek. të 4-të p. Kr. (i gdhendur në një nga ndenjëset e teatrit), tregon se ndërtimi i tij u bë i mundur nga dhurimet e besimtarëve për fältoren. Gjeografi Hekateu i Miletit e përshkruan *Buthrotum* si një port të rëndësishëm dhe qendër tregtare në rrugën kryesore detare të Adriatikut.

Në vitin 228 p. Kr. Butrinti ra nën sundimin romak dhe në shek. I p. Kr. u bë pjesë e provincës romake të Maqedonisë. E ngritur nga Jul Cezari, *Colonia Iulia Buthrotum*, njohu zhvillimin më të madh në periudhën e sundimit të Augustit, kur u njoh si *Colonia Augusta Buthrotum*. Qyteti rrethohet sërish me mure mbrojtëse dhe përfshihet në një program të madh ndërtimor të sferës publike. Butrinti i kësaj periudhe, i cili ndryshonte shumë nga qendra e vjetër e lidhur me fältoren e Asklepit, përfshinte ndërtime të çdo lloji, tempuj, forumin, teatrin e ripërshtatur në stilin romak, shatërvanë, banja (*thermae*), vila (banesa private). Të kësaj periudhe janë dhe ndërtimi i ujësjellësit të ri dhe i urës që lidhte të dy brigjet e kanalit të Vivarit. Në shek. e 5-të Butrinti bëhet seli peshkopale. Qyteti i kësaj periudhe ruan dëshmi mbresëlënëse të artit dhe arkitekturës së hershme të krishterë, të tilla si: pagëzimorja dhe bazilika e madhe, ndërtime të fillimit të shek. të 6-të. Në pjesë të tjera të qytetit deri më tani janë gjetur 8 kisha të tjera, më e rëndësishmja e të cilave ndodhet në fushën e Vrinës, në bregun tjetër të kanalit të Vivarit.

Shekujt e Mesjetës japin të dhëna fragmentare për Butrintin. Qyteti u përfshi fillimisht në lufrat për pushtet midis bizantëve, normanëve, anzhuinëve, venedikasve dhe më pas, në konfliktin midis Venedikut dhe Perandorisë Osmane

Në fillim të shek. të 19-të, megjithëse hyrja në Butrint duket se ka qenë e fortifikuar, qendra tashmë ishte kthyer në një vendbanim të vogël peshkatarësh. Në derdhje të kanalit të Vivarit, aty rreth vitit 1807, Ali Pashë Tepelena ndërtoi edhe kalanë e tij, për të siguruar mbrojtjen ndaj sulmeve franceze, që vinin nga Korfuzi. Pas vdekjes së Pashait, Butrinti kaloi në zotërim të osmanëve, deri në Shpalljen e Pavarësisë.

Është bashkëprania e monumenteve historike, natyrës dhe peizazhit ajo që e bën Butrintin unik. Qyteti antik, i shpallur në 1992 “*Pasuri e Trashëgimisë Botërore*” të UNESCO-s, sot ndodhet brenda Parkut Kombëtar të Butrintit. Ky park kombëtar ka një sipërfaqe totale prej 9424,04 ha dhe që prej vitit 2003 gëzon statusin *zonë ligatinore* me rëndësi ndërkombëtare - “Zonë RAMSAR”. Zona cilësohet si mjaft e larmishme përsa i përket florës dhe faunës që strehohet aty. Në të numërohen rreth 800 lloje bimësh ku 16 konsiderohen të rrezikuara si dhe 12 lloje të rralla. Deri më sot, në kompleksin ligatinor të Butrintit, janë identifikuar deri në 246 lloje shpendësh, 105 lloje peshqish dhe 39 lloje gjitarësh e, ndër ta, dhe mjaft lloje me *status të veçantë ruajtjeje*.



Muzeu i qytetit antik i rihapur në vitin 2005 në kalanë e akropolit paraqet një ekspozitë kronologjike të historisë së Butrintit, nga Epoka e Bronzit deri në Mesjetën e Vonë.




ZYRA E ADMINISTRIM KOORDINIMIT BUTRINT  
Parku Kombëtar Butrint, Sarandë, Shqipëri

Web: [www.butrint.al](http://www.butrint.al), e-mail : [pkbutrint@yahoo.com](mailto:pkbutrint@yahoo.com)



## PARKU KOMBËTAR I BUTRINTIT







## Rrugëtim në qytetin antik

1. Kullë venedikase e ndërtuar në shekujt 15-të dhe 16-të.
2. Faltore e shek. 4-të p. Kr., kushtuar perëndisë Asklep
3. Teatri antik, ndërtim i shek. 3 të p. Kr., i përshtatur më vonë në stilin romak dhe i pajisur me një skenë romake.
4. Banjë romake (Thermae) e shek. 2-të m. Kr.
5. Agoraja/Forumi - epiqendra qytetare dhe tregtare e qytetit
6. Gjymnazium-i, ndoshta një vend i shenjtë pagan, më vonë i transformuar në kishë
7. Shtëpi (Villae) qytetare romake e transformuar në shek. e 5-të në një pallat me një dhomë ngrënieje trekëndore (pallati trikonk).
8. Pagëzimore e fillimit të shek. 6-të, me dysheme të punuar me mozaikë.
9. Shatërvan i shek. 2-të m. Kr. kushtuar Nimfave.
10. Bazilika e Madhe – Godinë kulturi e periudhës së krishtërimit të hershëm, ndërtuar në shek. e 6-të m. Kr.
11. Porta e Liqenit – një portë e përsosur helenistike e shek. 4-të p. Kr.
12. Porta e Luanit – një portë tjetër e rindërtuar në periudhën e Mesjetës.
13. Akropoli – i ngritur në kodër me gjurmë të hershme të përdorimit që datojnë në shek. e 8-të p. Kr.
14. Kështjella venedikase e shekujve 14-të dhe 16-të, rindërtuar në vitet 1930.
15. Muzeu i Qytetit antik të Butrintit

Mirësevini  
Ju jeni këtu